

NJOFTIM PUNE

Balfin Group është një ndër grupet private investuese më të mëdha në Shqipëri dhe rajon, i pranishëm me aktivitete për zhvillimin e pasurive të paluajtshme, shitjet me pakicë, ofrimin e shërbimeve dhe manaxhimin e hapësirave tregtare apo industrial, miniera e metalurgji, etj.

Agrocon Albania Sh.p.k është një kompani shqiptare që zhvillon aktivitetin e saj në fushën e bujqësisë. Aktivitetet përfshin prodhimin e perimeve të fresketa në serë, në fushë të hapur, grumbullimi i perimeve nga fermerët e zonës si dhe shitja me shumicë për eksport dhe në tregun shqiptar.

Pozicioni:	Specilist i Burimeve Njerëzore
Raporton:	Administratori i Shoqërisë
Shoqëria:	Agrocon Albania shpk
Vendndodhja:	Fshati Ngurrëz e Vogël, Lushnje

Përmbledhje: Specilist i Burimeve Njerëzore ka funksion bazë funksionimin e të gjitha programeve të Burimeve Njerëzore në shoqëri, përgatit strategjitë e programeve të BNJ, përgatitje e procedurave për administrimin e personelit në përputhje me ligjet në fuqi.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përgjegjës për impementimin e të gjithë procedurave të BNJ, administrim, rekrutim, trajnim , vlerësim performance etj;
- Koordinon gjithë procesin e rekrutimit, përgatit JD në bashkëpunim me drejtorët e departamenteve, nxjerr njoftimet, organizon intervistat dhe procesin e punësimit të punonjësve të rinj;
- Administron dosjet e personelit, përgatit kontratat e punës, pagat, kryen deklaratimet perkatëse në zyrën e punës dhe tatim-taksa;
- Ndjek dhe zhvillon procesin e vlerësimit të performancës së punonjësve;
- Koordinon procesin e trajnimit dhe zhvillimit të stafit bazuar në nevojat e identifikuar;
- Ndjek procedurën e largimit të punonjësve;
- Përgatit dokumentacionin e nevojshem për lejet e lindjes të stafit;
- Mban lejet vjetore te stafit/raportet shëndetësore;

- Monitoron respektimin e orarit zyrtar të punës nga stafi sipas Qarkorës së Brendshme për Listeprezencën;
- Kujdeset për nevojat për trajnim të stafit sipas kërkesës së Departamenteve dhe plotëson skemën e amortizimit të trajnimit.
- Përgatit dokumentacionin e nevojshëm për aplikim për Leje Pune dhe Leje Qëndrimi për punonjës me shtetësi të huaj.
- Raporton pranë Adminsitratorit dhe HR Balfin sipas kërkesave.

Kërkesa dhe kualifikime

Edukimi: Diplomë Universitare në degën Administrim Bisnes, Shkenca Sociale;

Eksperiencë Pune: Të ketë ekperiencë pune të mëparshme si në fushën e manxhimit te BNJ.

Kualifikime të tjera:

- Aftësi të shkëlqyera organizative, duke përfshirë aftësi për të planifikuar punën dhe vendosur prioritete;
- Aftësi të shkëlqyera komunikuese, të zotërojë etikë pune dhe integritet;
- Afësi të shkëlqyera analitike dhe aftësi për të zgjidhur në mënyrë efikase problemet;
- Zotërimi i gjuhës angleze përbën përparësi;
- Aftësi shumë të mira për të ruajtur informacionin konfidencial;
- Të ketë aftësi në përdorimin e kompjuterit dhe gjenerimin e raporteve;
- Aftësi për të koordinuar punën;
- Aftësi për të marrë iniciativa dhe propozuar përmirësime në sistemin e manaxhimit të BNJ.
- Mundësia për të udhëtuar me frekuenca të shpeshta në terren, fshati Ngurrëz e Vogël, Lushnje.

Procedura e aplikimit:

Për të aplikuar për këtë pozicion, jeni të lutur të dërgoni CV tuaj nëpërmjet emailit tek adresa hr@agroconalbania.al

Afati i dorëzimit: 17 Tetor 2017

Do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur për intervistë.

* Të gjithë aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet sipas ligjit Nr.9887 të vendosur nga Parlamenti i Shqipërisë mbi "Mbrojtjen e të dhënave personale".